

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

NDERTIMI I “URA E MAMZOTAJ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi për ura 45221100-3 Punime ndërtimi për ura 45221110-6

VLERA E FONDIT LIMIT:

66,763,602.3 (gjashtedhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e gjashtedhjetë e tre mijë e gjashtëqind e dy pike tre) leke pa tvsh

Kohëzgjatja e kontratës ose afati për zbatimin e saj: 2(dy) muaj

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Pogradec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (regjistrat tregtarë, sipas nenit 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së) dhe të kete në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”si dhe nenit _____

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të viteve 2022, 2023 dhe 2024, lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar mësipër. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kërkesa për paraqitjen e xhiros së viteve financiare 2022, 2023 dhe 2024, nuk i kufizon operatorët ekonomik vetëm në vite që mund të jenë jo të sukseshme financiarisht, por me kohështirje tre vjeçare. Vlera e xhiros së kërkuar në masë jo më e vogël se vlera e fondit limit shkon përshat me vlerën e fondit limit dhe afatin e realizimit të kontratës. Konkretisht niveli i aktivitetit të shoqërisë është në masë financiare ekuivalent me vlerën e mundshme të kontratës objekt prokurimi.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të balanceve të viteve 2022, 2023 dhe 2024 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në nenin 43 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mësipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor para lidhjes së marrëveshjes kuadër.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.
- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve “a” ose “b” e bën ofertën të kualifikueshme

Për të provuar këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Ne rastin e kontratave të ngjashme me sektorin publik të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rast se kontratat e ngjashme janë lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqiten edhe kontratat e bashkëpunimit midis tyre.
- Ne rastin e kontratave të ngjashme me sektorin privat të paraqiten si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet referuar nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.2 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, të kategorive:

N.P-1A (Punime germimi e toke)

N.P-4 A (Rruge,autostrada,mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro)

N.P. 5 B (Punime nëntokësore, ura e vepra arti)

N.P-12 A (Punime te inxhinjerise se mjedisit)
N.S.-1A (Punime per prishjen e ndertimeve)
N.S.-7 A (Barriera dhe mbrojtje rrugore)
N.S- 8A (Ndërtimë parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri)
NS-18 A (Punime topogjeodezike)

Operatorët ekonomikë duhet të kenë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë ata duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimore

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, Neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane" si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", pika 1.1 ku përcaktohet se: çdo subjekt juridik i licencuar ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi, vetëm në klasat dhe kategoritë e punimeve, që ka përcaktuar në licencë. Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë subjekti juridik për të fituar klasa e kategori në zbatimin e punimeve të ndërtimit, përcaktohen në rregulloren për dhënien e licencave profesionale, që miraton Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.

NP-1 APunime gjërmimi në tokë

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, punime gjërmimi në tokë konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime gjërmimi, sistemimi të dherave dhe ndryshime të volumit të tokës, si rezultat i **Ndërtimit të ures Memzotaj** . Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve të gjërmimit të dheut.

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.P - 4 ARrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime qe përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaji, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

Këto punime janë parashikuar në preventiv, si shtrese binderi me granil gur kave, shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, trotuar dhe bordura trotuari etj. Për zbatimin e punimeve të tilla është e nevojshme që të anagzhohen subjekte të specializuara, të cilët zotërojnë licensën N.P – 4. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit

N.P - 5 B Punime nëntokësore, ura e vepra arti

Sipas VKM nr.759 të datës 12.11.2014 (Ndryshuar me VKM nr.943, datë 28.12.2016) më sipër cituar punime të tilla konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi "goma" ose mbi "hekur", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse.

Vendosja si kriter teknik i kësaj license lidhet ngushtë me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij projekti. Për sa me sipër ne total vlerat për realizimin dhe kompletimin me strukturat e nevojshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje i përcaktojnë të tilla punime në kategorinë B sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, të ndryshuar.

N.P - 12 A Punime të inxhinierisë mjedisore

Si punime të tilla, në VKM nr.42 të datës 16.01.2008 konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurorë, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.

Ndërhyrja objekt kontrate parashikon ndërhyrje në Rehabilitimin e sipërfaqes mjedisore të demtuara.

Ndërhyrje të tilla përfshihen në veprimtaritë me ndikim në mjedis. Efektet kryesore në mjedis nga punimet për rehabilitimin e rruges, konsistojnë në vija të përgjithshme si më poshtë: a) emetimet në ajër dhe zhurmat, b) shkarkimet në ujë, ndikimi në tokë, c) ndikimi në florë/faunë, ç) mbetjet e prodhuara d) ndikime social-ekonomike, dh) ndikim në cilësinë e jetës në komunitetin përreth e) ndikim në rritjen e trafikut rrugor, ë) ndikim në peizazhin e zones, h) ndikim në ndryshimet klimatike etj.

Mbështetur në legjislacionin në fuqi, në fushën mjedisore, i cili i përfshin të tilla aktivitete në aktivitetet me ndikim në mjedis Autoriteti Kontraktor ka realizuar Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Raportin Teknik të VNM, si dhe ka marrë Vendimin për VNM Paraprake pranë Institucionit kompetent. Ndikimet në territor nga zbatimi i këtij projekti dhe masat për zbutjen e efekteve shtjellohen në Raportin e VNM.

Masat me efekt financiar për zbutjen e efekteve negative dhe riaftësimin e territorit janë përfshirë në preventivin e punimeve. Në preventiv parashikohen zëra të tillë si: transport materiale ndërtimi, dheu dhe depozitim i mbetjeve në landfill. Këto masa janë të nevojshme për procesin e riaftësimit natyror dhe botanik të territorit të përdorur për ndërtim me mbetje të mëdha inerte. Për realizimin e punimeve të parashikuara në preventiv dhe specifikime teknike për riaftësimin e territorit të parcelës ndërtimore është e nevojshme që OE të disponojë licensën përkatëse. Kategoria A i referohet vlerës totale të punimeve për riaftësimin e territorit dhe zbutjen e efekteve negative në preventivin e projektit të zbatimit. Kriteri në fjalë, është një kërkesë e domosdoshme në përputhje të plotë me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ushtron veprimtarinë e vetë në fushën e ndërtimit dhe ka kapacitetet teknike të nevojshme për zbatimin e kontratës. Kjo është një kërkesë minimale në përpjestim me vlerën dhe rëndësinë e kontratës që prokurorët, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, dhe që ka për qëllim të provojë se operatori ekonomik ka kapacitetet teknike për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

N.S –1 A Punime për prishjen e ndërtimeve

Me punime të tilla, sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar *konsideron çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksploziv me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.*

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Projekti i **Ndërtimit të ures Memzotaj** është shoqëruar me prishjen e soletave të betonit, mur betoni/arme. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.S - 7 A Barriera dhe mbrojtje rrugore

Me punime të tilla, sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar *konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja rristurimi i elementeve si guard rail, në jersey, zvogëlesit e zhurmave, barrierat në kthesa dhe të ngjashme, të realizuar për të siguruar fluksin e mjeteve rrugore dhe për të mbrojtur rënien në kthesa*

Këto punime janë parashikuar në preventiv. Për zbatimin e punimeve të tilla është e nevojshme që të anagzhohen subjekte të specializuara, të cilët zotërojnë licensën N.S – 7. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit

N.S- 8 A Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri

Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrike prej betoni të armuar, normal dhe të parandëruar. Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara. Vendosja e këtij kriteri u referohet punimeve të parashikuara në projektet teknike, relacionet teknike, specifikimet, preventivin dhe grafikun e punimeve për zbatimin e veprës. Këto punime parqiten të detajuara në projektin arkitekturor dhe specifikimet e punimeve ndërtimore. Punimet e parashikuara në këtë dokumentacion teknik përfshijnë F.V Trare gjatesore të parafabrikuara Ba C35/45, L deri 15ml. Vëllimi dhe vlerat e punimeve të tilla janë të konsiderueshme. Për zbatimin e punimeve të tilla, VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar, përcakton se duhet të disponohet licensa NS-8.

Nga sa më sipër, duke marrë në analizë të gjithë dokumentacionin teknik, specifikën e punimeve dhe vlerat e të gjithë punimeve të tilla në preventivin total të kësaj ndërhyrjeje, u vendos si kriter teknik profesional licensa NS-8 A, e cila është e domosdoshme për vlerën, rëndësinë dhe kompleksitetin e punimeve të tilla.

N.S - 18 A Punime topogjeodezike.

Punime të tilla përfshijnë zbatimin e rëlvimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, *punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*

Sikurse shtjellohet në specifikimet teknike të punimeve ndërtimore, mbështetur në dokumentacionin topografik të hartuar nga projektuesi dhe dokumentacionin e pronësisë së objektit, Kontraktori duhet të kryejë transferimin e pikave referenciale dhe gjurmës së objektit në terren, si dhe çdo shërbim tjetër topografik, të nevojshëm për zbatimin e saktë të projektit.

Shtesa tre kateshe e objektit të parashikuar të ndërtohet ka një planimetri sheshi dhe një kufi prone me formë të thyer, planimetritë e tij zhvillohen në disa nivele dhe disnivele, volumetria është komplekse dhe zbatimi jo i saktë i të projektit në të gjitha nivelet mund të çojë në dëme kolosale dhe pamundësi teknike për realizimin e duhur të këtij konstruksioni. Kategoria A i referohet vlerës totale të punimeve për riaftësimin e territorit dhe zbutjen e efekteve negative në preventivin e projektit të zbatimit. Kriteri në fjalë, është një kërkesë e domosdoshme në përputhje të plotë me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ushtron veprimtarinë e vetë në fushën e ndërtimit dhe ka kapacitetet teknike të nevojshme për zbatimin e kontrates. Kjo është një kërkesë minimale në përpjestim me vlerën dhe rëndësinë e kontratës që prokurohet, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, dhe që ka për qëllim të provojë se operatori ekonomik ka kapacitetet teknike për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të jete i licensuar nga QKB me

- a. Licencë kategoria III.2.B për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim, rikuperim të mbetjeve të llojeve të ndryshme”

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, licencat e mesiperme duhet të disponohen nga anetari që do të kryejë shërbimet perkatese).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendim Nr. 538 date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nenligjore të perbashketa”. si dhe ne permbushje të detyrimeve ligjore që përcakton Ligji 10431 date 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (te ndryshuar).

Ky kriter synon mbrojtjen e mjedisit dhe shendetit nga ndotja dhe demtimi prej mbetjeve të ngurta, nepermjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, perpunimin, magazinimin, asgjësimin, të cilat çojnë në pakesimin e mbetjeve dhe zvogelimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të demshme. Duke qene se në preventivin e punimeve janë pasqyruar punime prishje, germimi është gjykuar që subjekti duhet të ketë lejen e posaçme për veprimtari të tilla si Stacionim transferimi për mbetjet nga prishjet dhe ndërtimet, për mbetjet e ngurta urbane dhe magazinim i perkoshëm i tyre.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat/lejet profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e proceseve të punës të parashikuara në preventivin objekt kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

2.3.4.Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) **Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem si dhe të ketë eksperiencë pune.

- i. Libreze pune (perkatëse)
- ii. CV perkatëse
- iii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)
- iv. Diplomë

Argumentimi: *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe detyrimeve ligjore në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, ***drejtues teknik në licencën e shoqërisë ofertuese***, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi (profile infrastrukture transporti) 1(një)
- Inxhinier Mekanik 1(një)
- Inxhinier Mjedis 1(një)
- Inxhinier Gjeodet / Topograf 1(një)

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Korrik- Shtator 2025. Për inxhinierët duhet të paraqiten:Diploma, Kontratë individuale pune (*e vlefshme*),librezë pune, CV.

2.3.6 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe ***stafin mbështetës*** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- | | |
|-------------------------|-----------|
| - Inxhinier Materialesh | - 1(një) |
| - Arkitekt Peisazhi | - 1 (një) |

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë dhe në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Korrik- Shtator 2025. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (*e vlefshme*), librezë pune, CV.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këto kritere i ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6.

Keto kritere i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për tu bindur se OE zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Këtu nga AK janë përcaktuar kriteret e nevojshme për personelin e kualifikuar sipas niveleve të ndryshme të kualifikimit dhe profileve të nevojshme mbështetur në tipologjinë e punimeve, si dhe kërkesat për fuqi punëtore referuar përmasave dhe natyrës së kontratës, objekt prokurimi.

Në kërkesat për personelin e kualifikuar janë kërkuar ekspertët inxhinierë të licensuar, sipas profileve të domosdoshme për të mbuluar të gjitha punimet e parashikuara në projekt – zbatimin e parashikuar të relizohet nëpërmjet kësaj kontrate. Një pjesë e këtyre ekspertëve duhet të jenë të përfshirë në licensën e shoqërisë, ndërsa pjesa tjetër jo domosdoshmerisht të përfshirë në licensën e shoqërisë, por me kontratë pune.

-Projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon punime të përgjithshme ndërtimore, të tilla si punimet e gërmimit, punimet e shtresave të rruges, punime betonimi etj. Punimet e ndërtimit duhet të përmbushin kushtet teknike të zbatimit. Respektimi i kërkesave për qëndrueshmëri strukturore dhe qëndrueshmëri, përdorimi i materialeve që nuk janë të dëmshëm për jetën dhe shëndetin e përdoruesve të ambienteve dhe saktësia në realizimin e të gjithë elementëve konstruktivë sjellin domosdoshmërinë që çdo element dhe hallkë e zbatimit të këtyre punimeve të ndiqet dhe udhëhiqet nga ekspertë të licensuar të fushës.

Zbatimi i punimeve të përgjithshme ndërtimore duhet të realizohet me materialet dhe teknologjitë e parashikuara në projektin e zbatimit, metodologjia e ndëkur e zbatimit të këtyre punimeve duhet të përputhet me specifikimet teknike dhe standardet dhe kriteret e zbatimit nga ekspert inxhinier ndërtimi. Ndjekja e të gjithë procesit ndërtimor që në fazën e pare, punimet e ngritjes së kantierit, realizimi i strukturës mbajtëse, punimet e përfortimit strukturor në preventvin respektiv. Për ndjekjen e punimeve të përgjithshme ndërtimore dhe strukturore në këtë objekt do të ishte e nevojshme që të angazhohesh një inxhinier ndërtimi. Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar angazhimi i të paktën një eksperti inxhinier ndërtimi i licesnuar në profilin infrastrukture transporti, i cili të jete të përfshirë në licensën e shoqërisë.

Inxhinieri i Ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit si dhe për sigurimin teknik në proceset e punës. Ky inxhinier ka për qëllim menaxhimin e zbatimit të punimeve ndërtimore, analizimin e projektit pasi kemi të bëjmë me punime ndërtimi apo rikonstruksioni, ndjekjen e ecurisë së punimeve në kantier;

- Gjatë zbatimit të punimeve të nëntokës është e domosdoshme që të mbahen në konsideratë faktorët gjeologjikë, integrimi i projektit dhe ambientin përreth, kërkesat konstruktive dhe teknike dhe rjetet nëntokësore. Duhet të merren masat për sigurimin e rruges. Për ndjekjen e punimeve të tilla dhe shmangien e ngjarjeve të rrezikshme, apo marrjen e masave për zgjidhjen e problematikës konstruktive nga një ngjarje eventuale është e domosdoshme që pjesë e stafit inxhinierik të OE të jetë edhe të paktën një inxhinier ndërtimi gjeodet/ topograf. Ai duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë si drejtues teknik, duke qenë se drejtuesit ligjorë dhe teknikë të OE janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës.

Inxhinieri Gjeodet/ Topograf është përgjegjës për dhe do të kryejë azhominimin topografik dhe

piketimin e objektit ndërtimor, si dhe do të ndjekë punimet e zbatimit sipas kuotave të projektit. Gjithashtu pas përfundimit të punimeve do të bejë edhe azhurnimin faktit (as built). Ky inxhinier është i nevojshëm për dhënien në terren të kuotave të nevojshme mbi dhe nën tokësore gjatë zbatimit të punimeve të objektit deri në përfundimin e plotë të tij në përputhje me kuotat e përcaktuara në projektin e zbatimit të objektit.

-Punimet për riaftësimin e territorit, si rezultat i dëmeve në mjedis që do të shkaktohen si rezultat i punimeve ndërtimore për zhvillimin e territorit nëpërmjet ndërtimeve të reja duhet të drejtohen nga të paktën një inxhinier i licensuar në fushën përkatëse, inxhinier mjedisi. Ky inxhinier duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë, në përputhje me pikën 1.2 të Udhëzimit nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, ku thuhet se *drejtuesit ligjorë dhe teknikë të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi.* Inxhinieri Mjedisi është përgjegjës për mbarvatjen e të gjitha punimeve dhe sigurimin që punimet e kryera mos cenojnë kushtet dhe parametrat mjedisorë të terrenit dhe të këne ndikim sa më të vogël në mjedis.

-Projekti që do të zbatohet nëpërmjet kësaj procedure prokurimi përmban si komponent të tij edhe F.V - guardrail H2 anesore për ure me 3 valez. në 1 ane, W4+rrjete. Ky projekt përmban zgjidhjet grafike, relacionin teknik, specifikimet teknike dhe preventivin e realizimit të punimeve të tilla. Realizimi i këtij zeri për të gjithë vëllimin e objektit është shumë i rëndësishëm për sigurimin e komfortit në rrugë. Sikurse shtjellohet në relacionin teknik përkatës, *parametrat projektuese të projektit janë marrë në përputhje me tipin dhe destinacionin e objektit dhe ambienteve të veçanta të tij.* Sigurimi i një komforti rrugor duke veçuar tipologjitë e veçanta funksionale është domosdoshmëri. Nisur nga vëllimi i punimeve, sjell nevojën që minimalisht të angazhohen në zbatimin e punimeve një ekspertë inxhinierë mekanikë i licensuar i përfshirë në licensën e shoqërisë.

-Në zbatim të projektit të parashikuar për kompletimin e veprës dhe kërkesës së domosdoshme për të krijuar një peisazh sa më bashkëkohor është kërkuar angazhimi i një i arkitekt peisazhi, i cili duhet minimalisht të jetë diplomuar në fushën përkatëse dhe jo domosdoshmërisht duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë.

Nisur për nga rëndësia dhe në përputhje të plote të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë një Inxhinier Materialelesh për realizimin me sukses të kontratës.

Është arsyetuar e nevojshme dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës vendosja e kësaj kërkesë për stafin teknik, pasi zbatimi i projektit kërkon që të gjitha materialet që do të vendosen në objekt të jenë cilësore dhe në përputhje me standartet europiane të cilësive si dhe të garantohet siguria rrugore gjatë kryerjes së punimeve.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- **1 (një)** punonjës të disponojë certifikatë si **"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", e dhënë nga një organizëm i akredituar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punës. Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.
- **1 (një)** punonjës i pajisur me certifikatë **"Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj**

emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit si Ekspert per dhenien e ndihmes se pare dhe nderhyrjes ndaj emergjencave” e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE.*

Argumentimi 2.3.5: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" Neni 7 Sherbimet e mbrojtjes dhe te parandalimit ... 1. Punedhenesi ngarkon nje ose disa punemarres, qe te merren me ceshtjet e mbrojtjes, te sigurse e shendetit ne pune dhe te parandalimit te rreziqeve profesionale ne ndermarrje /institucion, dhe V.K.M nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier". Autoriteti Kontraktor ka qellim realizimin e kontrates objekt prokurimi sipas kushteve te percaktuara ne DST, duke respektuar cdo rregull lidhur me kantierin e ndertimit si dhe me sigurine e punonjesve gjate ushtrimit te veprimtarise se punes. Eshte e rendesishme qe punimet te realizohen brenda nje kantieri te sigurt duke mbrojtur jeten e punonjesve, por dhe te kalimtareve qe mund te jene perreth vendit te punimeve. Per sa me lart, punonjesi i cili eshte i certifikuar si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune", nepermjet dijes dhe eksperiences te fituar ne kete fushe, duhet te shmange apo parandaloje cdo rrezik qe mund te shfaqet gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe mund te cenoje shendetin apo sigurine ne pune. Ne keto kushte, vendosja e ketij kriteri sherben si nje garanci qe ofertuesit do te reazlizojne punimet sipas standarteve ligjore ne fuqi.

Bazuar dhe ne V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënëz zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

2.3.8. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim për fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht 107 (njqind e shtate) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, shoferë, manovratorë, stafi teknik) për periudhën Korrik- Shtator 2025, i lëshuar nga Administrata Tatimore.
- Listëpagesat për periudhën Korrik-Shtator 2025, sipas formatit të miratuar nga Administrata Tatimore.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të përmbushur kërkesat e mësipërme, per pikat 2.3.4 – 2.3.8 operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përcaktuar numrin e punonjësve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim", sic përcaktohet ne tabelen bashkelidhur.

Kete perlllogaritje si nevojë e transparencies ndaj ofertuesve po e paraqesim te detajuar si me poshte:

Nr	Nr.An.	Lloji i punimeve	Njesia	Sasia	ore pune/njesi	ore pune total
PUNIME NERTIMI						
1. Punime germimi dhe dehrash						
1	2.3	Germim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m3,shkarkimi ne auto	m3	237		-
2	3.396/1	Mbushje me zhavorr pas mureve	m3	345.58	0.04	13.82
3	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	237		-
4	2.426/4	Prishje soleta b/a	m3	19.8	25.7	508.86
5	2.426/6	Prishje mure beton/arme	m3	31.5	27.5	866.25
6	Tregu	Pagesa e depozitimit ne landfill	ton	539.46		-
2. Punime shtresash nen themele dhe solete						
1	3.193/c	Shtrese zhavor lumi t=30cm, me cilindrim - nen themele	m2	139.5	0.23	32.09
2	2.262/4	Shtrese betoni C 16/20 - nen themele	m3	139.5	8.6	1,199.70
3	2.2	Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm	m2	270	0.65	175.50
4	2.196	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama	m2	270	0.7	189.00
3. Punime themelsh dhe pilotash						
1	3.455/1	Shpim me sonda "UKS" 0 lm, - 20m, toke ranore.	ml	660		0

2	2.37/Sb	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	911.85		0
3	Tregu	Pagesa e depozitimit ne landfill	ton	1,641.33		0
4. Punime betoni dhe hekuri, betonimi						
1	Ana-01	F.V Beton C30/37 per pilotat, 0100	m3	912	8.6	7,843.20
2	2.583	F.V Beton C30/37 per pllaken e themeleve	m3	159.43	8.6	1,371.10
3	2.117/lb	F.V Beton C30/37 per kolona/mure	m3	162.94	31.22	5,086.99
4	2.574	F.V Beton C30/37 per trare	m3	175.29	20.6	3,610.97
5	2.122/lb	F.V Beton C30/37 per soleta	m3	53.98	22.89	1,235.60
6	2.699	F.V Beton C30/37 per soletat rakorduese	m3	67.19	18.76	1,260.48
7	Ana-02	F.V Soletina C25/30, t=Scm, per mbulimin e soletes se ures	cope	4	18.76	75.04
8	Ana-03	F.V Trare gjatesore te parafabrikuar Ba C35/45, L deri 15ml	cope	10	80	800.00
9	3.288	F V hekur betoni i zakonshem 0 > 12mm	ton	105	42	4,410.00
5. Punime te ndryshme						
1	3.165	Fuge me gome speciale me kanal te gjere ne ura	ml	27	20.7	558.90
2	Ana-04	F.V Pllaka neopreni - Sipas specifikimeve/dimensioneve te Projektit	m2	20	20	400.00
3	3.62	Trotuari me 6 cm beton, me pllaka	m2	108.57	2.14	232.34
4	2.29	Bordura trotuari 20x35cm te parapergatitura	ml	72.4	0.7	50.68
5	3.302	F.V - guardrail H2 anesore per ure me 3 valez. ne 1 ane, W4+rrjete	m2	72.4	2.28	165.07
6	3.222/1	Shtrese binderi me granil gur kave, 5cm, me makineri	m2	269.91	0.11	29.69
7	3.224/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri	m2	269.91	0.082	22.13
Ore pune ne total per kryerjen e punimeve				Referuar Normatives sipas Manualit te Ndertimit		30137.42
			Dite pune 8 orarshe ne total		3767.177	

Peruidha ne dite per kryerjen e punimeve sipas grafikut	44 dite	44
Numri i fuqise punetore per kryerjen e punimeve	dite pune total /44	85.61766
Numri i manovratoreve dhe shofereve te nevojshem	15	15
Numri i ing/specialisteve te nevojshem	6	6
Numri total i fuqise punetore per kryerjen e punimeve		106.6176

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si dhe të përfshirë në listepageses e muajit te fundit, me profesionet si mëposhtë:

Lloji i Specialistit	Numri i kerkuar
• Teknik Ndertimi	2
• Murator	1
• H/Izolues	1
• Hekurkthyes	9
• Karpentier	9
• Betonues	9
• Pllakashtrues	2
• Specialiste konstruksione metalike	1
• Mekanik	1
• Saldator	1

- të vertetuar me diploma/certifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën Korrik-Shtator 2025.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **15 punonjës manovratorë** të mjeteve të rënda (*11 automakiniste dhe 4 eskavatoriste*) si dhe **4 shofere kamioni**.

Per manovratorët deshmite e aftësisë profesionale nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme, dhe të figurojnë në listëpagesa të pakten tre muajt e fundit dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen sëbashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues. Per shoferin leje drejtimi e vlefshme dhe të figurojnë në listëpagesa të pakten Korrik-Shtator 2025.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit eskavatoriste, automakinist dhe shofere, emer/mbiemer, profil i punës, numri dhe datën e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerisë së deshmisë së aftësisë profesionale.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesis e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e stafit teknik në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

Argumentim Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39 , pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e punimeve. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht gjithashtu edhe me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.2 të kriterëve teknike. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve.

Në kriterin mesipercituar është kërkuar që OE të kenë të punësuar teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit.

Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar/certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive.

2.3.10 Operatori Ekonomik duhet të disponojë:

a- Ne Pronesi / Kontrate Qeraje/ Kontrate Furnizimi,Fabrika prodhimi i inerteve te pajisura me (Leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B) e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates objekt i këtij prokurimi.Furnizusi te kete status aktiv ne QKB. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, dokumentat e mësipërme duhet ti paraqesë të pakten njeri nga anëtarët e grupit)

b- Ne Pronesi / Kontrate Qeraje/ Kontrate Furnizimi,Fabrika prodhimi i betoni te pajisura me (Leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B) e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates objekt i këtij prokurimi. Furnizusi te kete status aktiv ne QKB. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, dokumentat e mësipërme duhet ti paraqesë të pakten njeri nga anëtarët e grupit)

c- Ne Pronesi / Kontrate Qeraje/ Kontrate Shërbimi me nje laborator testimi të materialeve kryesore të ndertimit beton, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombetar ose nderkombetar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2009, SSH EN 12350-2:2009 dhe SSH EN 12504-2:2012 e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates objekt i këtij prokurimi. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, dokumentat e mësipërme duhet ti paraqesë të pakten njeri nga anëtarët e grupit)

e- Kontrate furnizimi per hekur nga prodhuesi ose nga distributori e shoqeruar me autorizim prodhuesi, pajisur me ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit te Cilesise) e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates objekt i këtij prokurimi i cili duhet të jetë i certifikuar nga organizma kombetar ose nderkombetar sipas standarteve SSH EN 10080 :2005, SSH EN - ASTM A 510 dhe 615, dhe SSH EN DIN 488-2.

Argumentimi: Ne baze te nenit 77 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe piken 8, te nenit 40, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", me ane te ketij kriteri AK gjykon se disponimi ne pronesi apo me qera i ketyre fabrikave eshte nje dokumeut i rendesishem, pasi pervec se tregon origjinen e mallrave qe kerkohen ne procedure, garanton se ofertuesi eshte i garantuar per ofrimin tek Autoriteti Kontraktor te ketyre mallrave qe do te perdoren ne punimet e planifikuara. Kjo garanci lidhet njekohesisht edhe me treguesit cilesore te mallrave objekt prokurimi te cilat kerkohen qe te jene prodhuar ne perputhje me standardet dhe cilesite e kerkuara ne DST. Ky kriter eshte ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates dhe lidhet drejtperdrejte me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine e OE ofertues per aftesite teknike. Kjo kerkese i sherben autoritetit kontraktor per njohjen e mundesise se OE per permbushjen me sukses te kontrates pasi sasia e produkteve qe do te perdoren eshte e konsiderueshme.

2.3.11 Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet te paraqese autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me te cilin prodhuesi/distributori autorizon kompanine pjesemarrëse ne tender te ofertoje keto pajisje/mallra ne kete procedure prokurimi, si me poshte:

- Pllaka neoprene
- Fuge me gome speciale me kanal te gjere
- Guardrail
- Materiale Hidroizolimi me bitum dhe katrama
- Pllaka dhe bordure trotuari

Për rastin kur autorizimi dotë jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin(kontratë/autorizim)që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin

Autorizimi duhet të shoqërohet me certifikaten e cilësisë sipas Standartit ISO 9001:2015 (per sistemin e menaxhimit te cilesise) te prodhuesit, e vlefshme

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është në përputhje dhe proporcion me natyrën, objektin dhe volumin e kontratës objekt prokurimi. Duke marrë në konsideratë e dhe natyrën e punimeve, zërat të cilat kanë volum maksimal të lëndës bazë dhe materialeve të kryerjes së punimeve.Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në perpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Në këtë kontekst, referuar vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dokumentit te cituar nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë. Për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet sherbim me “mall” sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar. Neni 40 pika 6 germa b) e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t'u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit):

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 Ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 15 Ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me rimorkio me gjatesi min 30m, per terheqje te trupave te vecante	1 copë	Pronësi ose me qera
Rimorkator me kapacitet mbajtes mbi 40 Ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc me kapacitet mbajtes mbi 90 Ton dhe me gjatesi krahu jo me pak se 50 m.	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5 - 5 Ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinc kapacitet mbajtes 3.5 - 7 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrom me goma me kove para mbrapa	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.5m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Mini Fadrome	1 copë	Pronësi ose me qera
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator 30 ton, me kavo dhe hapje krahu 21	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir me hapje krahu mbi 21 m	1 copë	Pronësi ose me qera
Dumper 9 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Sonde "UKS"	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul ngjeshes 16 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobitumatriçe	1 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtuese	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe Betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri per montim guard rail	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri me piston per terheqje kavosh	1 copë	Pronësi ose me qera
Vullkanizator	1 copë	Pronësi ose me qera
Vinc kulle	1 copë	Pronësi ose me qera
Well Point – Sistem Drazhnimi	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere kantieri	3 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni thellesie	5 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni siperfaqesor (te jashtem)	5 copë	Pronësi ose me qera
Pllake vibruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Pajisje per hekurkthyes (tranxhe,elektrobango)	1 copë	Pronësi ose me qera
Kapese per lidhje hekuri	2 copë	Pronësi ose me qera
Elektro argano	1 copë	Pronësi ose me qera
Elektrosaldatriçe	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjeneratore	1 copë	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 107 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 10copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5copë
- Uniforma/Jelek pune 107 cope
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 25 copë

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash.*
- c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.*
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas Deklaratës së shoqërisë ofertuese.*
- f) Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e verifikimit të saktësisë së informacionit. Mos dorëzimi i informacionit të saktë apo të rremë do të konsiderohet kusht për skualifikim.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira / kontrate furnizimki janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e

kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Gjithashtu për përcaktimin e numrit të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

2.3.13 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001:2015 (për sistemin e menaxhimit të cilësisë)**, e vlefshme, *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE*
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015 (për sistemin e menaxhimit të mjedisit)**, e vlefshme, *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE*
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 45001:2018 (për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)**, ose certifikatën ekuivalente, e vlefshme, *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE*
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 39001:2012 (Sistemi i Menaxhimit Të Trafikut Rrugor)** - ose ekuivalent. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anëtari që do të kryejë punimet e perkatese*

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikatën, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë..

ISO 9001:2015 - Që një subjekt të jetë i pajisur me certifikatën ISO 9001, do të thotë se ky subjekt ka plotësuar kërkesat e këtij standardi mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”. ISO 9001:2008 specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

- duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat statutores dhe normative të aplikueshme.
- synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat statutores dhe normative të aplikueshme.

Me anë të kërkesës për paraqitjen e kësaj certifikate të 2008 ose të përditësuar, AK kërkon të vërtetojë se Oe ka kapacitetin për të garantuar konformitetin me kërkesat cilësore të tij.

ISO 45001 : 2018 - Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta dhe janë shtjelluar në kriteret e mësipërme, si dhe në specifikimet teknike të projektit të zbatimit. Për këtë arsye, Ak duhet të sigurohet se Oe zotëron kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës

Certifikata **ISO 45001 : 2018** dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

ISO 14001:2015 - Sikurse vëren edhe VNM e pregatitur nga projektuesi, zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kësaj kontrate. Të gjitha punimet e parashikuara në këtë procedurë duhet të kryhen në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të pregatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

Nga sa më sipër AK ka kërkuar që OE të paraqesë certifikatën ISO 14001:2015 (ose të përditësuar) për të dëshmuar kapacitetin për të kryer punimet në përputhje me rekomandimet e VNM, në konformitet me legjislacionin mjedisor në fuqi dhe standardet shtetërore dhe ndërkombëtare të menaxhimit mjedisor.

ISO 39001:2012 është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor (RTS). AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 39001:2012 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e qarkullimit rrugor, si dhe të reduktojë apo përjashtojë rreziqet e humbjes së jetës dhe plagosjeve të rënda në aksidentet e qarkullimit rrugor. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit ku mundësia për ngarkesën e trafikut rrugor është e lartë, me qëllim minimizimin e këtij risku, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me ISO 39001:2012.